



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve 13.1 shkronja a dhe 44.1 të Ligjit për tokën bujqësore nr. 02/L-26, neneve 6.2 dhe 8.6 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr.41/2006 i datës 27.12.2006 dhe neneve 15.2 shkronja d dhe 19 shkronja b të Statutit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2016, miratoi,

VENDIM

PËR LEJIMIN E NDËRRIMIT TË DESTINIMIT TË PËRHERSHËM TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE

Neni 1

Nebih Mursel Zhitia nga fshati Shakovicë Komuna e Podujevës, në cilësinë e pronarit, i lejohe ndërrimi i përhershëm i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të paluajtshmerisë së evidentuar sipas ngastrës kadastrale nr. 00047-12 kultura – bujqësore - arë kl. 1, vendi i quajtur Seishta-Përte Rruge në sipërfaqe prej 500 m² certifikata pronësore nr. 08-095/89908 të datës 04.11.2015, Zona Kadastrale Shakovicë.

Neni 2

Pronari, në emër dhe interes të të cilit bëhet ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore obligohet që paluajtshmerinë përkatëse ta shfrytëzojë vetëm për ndërtimin e objektit për banim dhe afarizëm dhe nuk mund ta përdorë për qëllime të tjera.

Neni 3

Regjistrimin, në librat kadastral, të pronës përkatëse për ndërrim të destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në emër të pronarit e bënë Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 4

Vendimi bëhet përfundimtar pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 8.6 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr.41/2006, përkatësisht pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

Zbatimin e vendimit e bëjnë Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 6

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmerisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-006-26549
Podujevë,
30 mars 2016



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government


Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office : PODUJEVË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Shkovicë

Njesia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m2
P-71712082-00047-12	Pracelë / Parcela / Parcel	500,0



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1000

Punoi/Obradilo/Created:

Data/ Data/Date: 06.11.2015

Koha/ Vreme/ Time: 09:01:46

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovot/Usvojilo/Approved: MCO PODUJEVË director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

